



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:233271  
Datë: 26.12.2024  
Numri i dokumentit: 06652636

**C-IV-14-0993**

*Parashtruesi i kërkesës*

**Korporata Energjetike e Kosovës – SH.A. Prishtinë**

*Kundër*

*Pala kundërshtare*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) ( NTSH “Qëndresa” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr.55, Lakrishte, Prishtinë**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 26 dhjetor 2024 , lëshon këtë:

**AKTGJYKIM**

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI101-0163 datë 17 janar 2014.**
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 21 shkurt 2014, ankuesi pranë DHPGJS, parashtron një kërkesë për rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) GJI101-0163 datë 17 janar 2014 (tani e tutje Vendimi), me të cilin i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për pagesa për fatura të papaguara të furnizimit me energji elektrike, në shumën prej 12,514.64 Euro dhe atë për periudhën 5 shtator 2002 gjer 15 nëntor 2006 për njuhësorin DGL-9013728 në shumën prej 2,746.00 Euro për periudhën prej 17 shtator 2002 gjer 23 mars 2007 për njuhësorin DGL-9000510 në shumën prej 8,754.22 Euro për periudhën prej 10 shkurt 2006 gjer 22 tetor 2007 për njuhësorin DGL-9013733 në shumën prej 810.56 Euro gjersa për periudhën prej 31 dhjetor 2008 gjer 25 gusht 2010 për njuhësorin DGL9011623 në shumë prej 383.10 Euro kërkesa është aprovuar si e bazuar, që të gjitha këto kërkesa ndaj NTSH “Qëndresa” (në likuidim).

Ankuesi fillimisht kontestoj arsyetimin e Vendimit të AL lidhur me faktin se AL ka konstatuar se disa fatura emërtohen në emër të personave fizik respektivisht juridik si dhe sa i përket çështjes së parashkrimit.

Ankuesi, duke ju referuar njëhësorëve DGL-9013728 dhe DGL-9013733, pretendon se transaksionet e konsumatorit janë ekstrakte nga librat afariste të kreditorit-ankuesit, dhe paraqesin dëshmi të besueshme, të sakta, dhe në të cilat pasqyrohet faturimi, gjendja dhe pagesat. Andaj, sipas ankuesit, këto duhet ti shërbenin AL si dëshmi të mjaftueshme dhe prova valide në kuptim të kërkesës kreditore.

Sipas ankuesit, shifrat e konsumatorit kiorespondojnë me shifrat që i përkasin NSH, pa marr parasysh se në transaksionet e konsumatorit figurojnë emra të tjerë dhe se është çështje e mbrendshme e AKP se si e zgjidh këtë çështje të borxhit për ndërmarrjen e privatizuar.

Ankuesi në vijim, lidhur me njëhësorin DGL-9000510 dhe borxhin prej 8,754.22 Euro, kontestoj Vendimin e AL lidhur me dispozitat e aplikuar mbi parashkrimin sepse, sipas ankuesit, lidhur me nenin 360 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve, AL si organ vendimmarrës nuk mund ti referohet një dispozite të tillë. Në vijim, sipas ankuesit, kjo dispozitë nuk mund të aplikohet sipas detyrës zyrtare, e që nënkupton se nuk mund të thirret as gjykata.

Ankuesi gjithashtu kundërshtoj edhe dispozitën e aplikuar, nga AL, lidhur me nenin 387 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve pasi që, sipas ankuesit, debitori në kontinuitet ka paguar borxhin për njëhësorin DGL-9000510.

Nga gjitha arsyet propozon gjykatës që Vendimi i AL të shfuqizohet dhe kërkesa e tij të aprovohet si e bazuar.

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Kopja e gjendjes mbi transaksionet, për njëhësorin DGL-9000510 e evidentuar në emër të Qëndresa Shtëpia e Mallrave - SHPK,
- Kopja e gjendjes mbi transaksionet, për njëhësorin DGL-9013728 e evidentuar në emër të Lokal –S K,
- Kopja e gjendjes mbi transaksionet, për njëhësorin DGL-9011623 e evidentuar në emër të Sh R S,
- Kopje të siç thuhet “Prerje e borxhit për konsumatorët e privatizuar” për njëhësorin DGL-9013728 për periudhën gusht, shtator, tetor dhe nëntor 2006 në shumë prej 2,746.77 Euro; DGL9013733 për periudhën maj, qershor, korrik dhe gusht 2007 në shumë prej 810.56 Euro; DGL9000510 për periudhën dhjetor 2006 si dhe janar, shkurt dhe mars 2007 në shumë prej 8,754.22 Euro dhe DGL-9011623 për periudhën dhjetor 2009 si dhe janar, shkurt dhe mars 2010 në shumë prej 383.10 Euro, që të gjitha këto në emër të NSH “ Qëndresa”, dhe
- Kopja e gjendjes mbi transaksionet, për njëhësorin DGL-9013733 e evidentuar në emër të Lokal – R R.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 25 qershor 2021, parashtrorj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. AKP fillimisht pohon se AL me rastin e vendosjes ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP tutje pohon se kërkesa për rishikim-ankesa, e ankuesit, nuk përmban argumentet e saj ligjore ashtu siç edhe parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP në vijim pohon se edhe përkundër kërkesës së drejtuar ndaj ankuesit për informata shtesë ankuesi sipas dokumentacionit të parshtruar, AL konsideroj se dëshmitë e parashtruara si ato mbi gjendjen e transaksioneve dëshmonin se evidentoheshin në emër të personave fizik respektivisht personave juridik. AKP përfundimisht pohon se kërkesa është e parashkruar, duke u bazuar në nenin 378 të Ligjit për

marrëdhëniet e detyrimeve. Nga gjitha arsyet AKP propozoj që kërkesa për rishikim të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigja e AKP ju dorëzua ankuesit me 26 korrik 2021.

Ankuesi nuk parashtoj përgjigje.

Duke vepruar sipas urdhrat të gjykatës, datë 15 korrik 2021, ankuesi me parshtrësën e parashtruar pranë gjykatës me 30 korrik 2021, dorëzoi Vendimin e kërkuar të AL ndaj së cilës është ushtruar kërkesa për rishikim-ankesa.

### **Arsyetimi Ligjor**

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Sipas Vendimit të AL shihet se kërkesat për pagesa të faturave të papagauara janë për katër njëhësorët dhe atë DGL-9013728, DGL-9000510; DGL-9013733 gjersa kërkesa për njëhësorin DGL9011623, sipas po këtij vendim është e aprovuar.

#### **Kërkesa për njëhësorët DGL-9013728 dhe DGL-9013733**

Kërkesa për rishikim – ankesa konsiderohet si e pabazuar.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parshtrësën e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsytimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Ankuesi si pranë AL, ashtu siç qëndron edhe në Vendimin e AL, e po ashtu edhe pranë gjykatës nuk ka parashtruar dëshmi mbështetëse me çka do të provohej borxhi i NSH, mbi pagesën e boxhit të papaguar për njëhësorët DGL-9013728 dhe DGL-9013733.

Kopjet e parashtruara të transaksioneve të konsumatorit, për njëhësorët, evidentohen në emër të personave fizik respektivisht bizneseve private- individuale. Ankuesi edhe në kërkesën e saj për rishikim-ankesës, ndër të tjerash, pohon se është e vetëdijshme se asetet janë të privatizuara por nuk i takon ankuesit por është çështje e brendshme e AKP se si do ta zgjidh këtë çështje, arsye këto që sipas gjykatës janë të pabazuara.

Ankuesi, me kërkesën e saj për rishikim – ankesën, nuk ka sqaruar se cili është obligimi eventual i NSH ndaj saj por kërkesa e saj përmban një obligim total dhe se ashtu siç edhe vetë e pohon lokalet janë në shfrytëzim dhe borxhi figuron ndaj personave fizik respektivisht bizneseve private.

Nga të gjitha të cekurat si më lartë gjykata konsideron se edhe AL me rastin e vendosjes, edhe përkundër kërkesës drejtuar ankueses – kreditorit, kërkesën e ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë dhe ka vendosur në pajtim me dispozitat ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP.

Andaj nga të gjitha arsyet e cekura si më lart ankuesi nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi kompensimin e faturave të papaguara, të njehësorëve të cekur si më lartë, ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Kërkesa për njehësorin DGL-9000510

Kërkesa për rishikim – ankesa konsiderohet si e pabazuar.

Të drejtat dhe autoriteti i AKP ndaj Ndërmarrjeve shoqërore

Ashtu siç parashihet me dispozitat e nenin 5 dhe nenin 6 të Ligjit mbi AKP ka kompetenca ekskluzive të administroj ndërmarrjet shoqërore si dhe autoritet që përfshinë çdo veprim që agjencia e konsideron të arsyeshëm dhe të duhur, brenda kufijve të burimeve administrative të Agjencisë, për të mundësuar më mirë shitjen, likuidimin, transferimin apo ndonjë zgjidhje tjetër të ndërmarrjes, asetit apo interesit në pronësi shtetërore. Pa paragjykim ndaj përgjithësimit në fjalinë e mëparshme, parashihet në mënyrë specifike që sa i përket ndërmarrjeve, ai autoritet të përfshijë të gjitha veprimet të cilat Agjencia i konsideron të arsyeshme dhe të duhura për ruajtjen ose rritjen e vlerës, shanseve për sukses ose qeverisjes së ndërmarrjes

Për më tepër autoriteti i likuidimit, mes tjerash, bën përcaktimin e vlefshmërisë së çdo pretendimi të bërë nga një kreditor i supozuar apo çdo pohim për barazi në interesat e pronësisë i bërë nga një pronar i supozuar dhe përcaktimin e shpërndarjes së duhur së të ardhurave të kreditorëve dhe pronarëve, janë përgjegjësi të autoritetit përkatës të likuidimit, i cili respekton rregullat e përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për AKP.

Të gjitha arsyet e lartë cekura ligjore, përmbajnë një arsyetim të mjaftueshëm, rreth pretendimeve ankimore se siç ceket: “ *AKP nuk mund të thirrej në parashkrimin e kërkesave respektivisht AL nuk është debitor por është NSH ndaj së cilës edhe është zhvilluar procedura e likuidimit*”, duke ju referuar sipas nenit 360 paragrafi 3 i LMD.

Neni 360 paragrafi 3 thekson si në vijim: “Gjykata nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë”. Sipas kësaj dispozite shihet se:

- Është gjykata ajo që nuk mund ti referohet parashkrimit nëse debitori/ët nuk thirret /n në të. E që në rastin konkret është NSH debitori e i cili administrohet nga AKP në pajtim me dispozitat ligjore, të cekura si më lartë.

Autoriteti i likuidimit, në rastin konkret gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës kreditore ka vepruar, në pajtim me nenin 36 të Shtojcës së Ligjit për AKP, ku edhe thuhet se: “*Autoriteti i Likuidimit refuzon, tërësisht apo pjesërisht, vlefshmërinë e Kërkesave apo interesit të pretenduar të kapitalit apo pronësisë nëse refuzimi i tillë obligohet apo lejohet sipas këtij ligji apo elementeve tjera të ligjeve të Kosovës në fuqi apo me urdhër të Gjykatës*”.

Fillimisht i referohemi kërkesës periudhën nga muaji tetor respektivisht nëntor 2002 e gjer muajin shtator 2007, shihet se veprimi i parë i kreditorit ndaj NSH, sipas kërkesës pranë AL, është ndërmarr me 24 mars 2011.

Pavarësisht pohimeve të palëve, në rastin konkret kemi të bëjmë lidhur me kompensimin e shërbimeve periodike, e në rastin konkret shërbimet mbi shpenzimet e energjisë elektrike.

Obligimet e shërbimeve, ndaj ankueses janë për periudhë nga muaji dhjetor 2006 e gjer muajin mars 2007, kur në fuqi ishin dispozitat e Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve ( gazeta zyrtare e RSFJ 29/78, me plotësime dhe ndryshime nr. 39/85, 45/89 – vendimi i GJKJ, 57/89, dhe nr.. 31/93).

Gjykata konsideron se AKP në vendimin e saj me të drejtë i është referuar parashkrimit, lidhur me nenin 374, të LMD.

Sikur edhe të aplikoheshin dispozitat e LMD të Kosovës, dispozitë të ngjashëm parasheh po edhe ky ligj, shih nenin 355.

Ankuesi, nuk ka ofruar asnjë dëshmi që do të tregonte se është iniciuar ndonjë procedurë ligjore ndaj debitorit (NSH) e që do të ishte arsye e ndërprerjes së parashkrimit apo arsye tjera ligjore të cilat do të ndërpresin parashkrimin.

Për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin gjersa në anën tjetër nuk është ofruar asnjë dëshmi që do të tregonte se debitori ka pranuar ekzistimin e borxhit ekzistues.

Gjykata gjithashtu konsideron si të pabazuar qëndrimin e ankueses se Ligji mbi AKP dhe Shtojca e saj, nuk mund të kenë efekt prapaveprues, posaçërisht për faktin e aplikimit të dispozitave mbi parashkrimin. Me Shtojcën e Ligjit për AKP, përcakton bazat dhe procedurat për likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Aseteve mbi të cilat Agjencia ka autoritet, në pajtim me Ligjin për AKP-në dhe të drejtat dhe obligimet e të gjithë pjesëmarrësve dhe palëve të prekura. Procedura e likuidimit të NSH është iniciuar sipas dispozitave të po këtij ligji dhe AL ishte e obliguar ti aplikoj dispozitat ligjore posaçërisht siç ka vepruar edhe në rastin konkret kur ka vepruar sipas nenit 36 dhe 37.1 të po këtij ligji.

Nga këto arsye gjykata konsideron se kërkesa e ankuesit për obligimet për fatura të papaguara të furnizimit me energji elektrike për periudhën e kërkuar, janë të pabazuara.

Andaj, nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

### **Taksa Gjyqësore**

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

### **Këshillë Juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

---

Gazmend Sylaj, Gjyqtar